

# STATUT

## I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

### “FORM ARCHITECTURE” shpk

*Në këtë statut*

- Ligji, është Ligji Nr. 9901 dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare”;
- Statuti, është Statuti i Shoqërisë

#### KREU I

#### THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA

##### Neni 1

##### Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

##### EMERTIMI

1. Sot me datë 01.09.2018, në Tiranë, ne themeluesit, kemi krijuar një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar me emrin “FORM ARCHITECTURE” shpk.
2. Themeluesi i Shoqërisë është Evis Laze (Ortaku i Vetëm), i datëlindjes 22.01.1989, lindur ne Gjirokaster dhe banues në Tiranë, me Nr. Licence A.1336/I , krijon Shoqerinë me Përgjegjësi të Kufizuar “FORM ARCHITECTURE” shpk
  - Forma e Shoqërisë është me “Person Juridik”;
  - Emri ligjor i Shoqërisë është “FORM ARCHITECTURE”;
  - Adresa e Shoqërisë është Rr. Andon Zako Cajupi, Nd.9 , H.7 , Ap. 11, Tiranë ;
  - Vendi i Regjistrimit është në Tiranë;

##### Neni 2

##### Objekti i Veprimtarisë

Objekt i veprimtarisë së shoqërisë " FORM ARCHITECTURE" - shpk është në përputhje me legjisacionin tregetar aktual shqiptar dhe do të jetë :

Studimi, projektimi, dhe ndertimi i objekteve te ndryshme, ushtrim i aktivitetit te studimit, projektimit, dizajnit grafik dhe ndertimit te gjitha llojeve, prodhimeve te materialeve te ndertimit, tregtimi i tyre, eksport-import i materialeve te ndertimit etj, hapje linjash e reparteve te reja per prodhimin e materialeve te ndertimit, import-eksport, shit-blerje me shumice e pakice te artikujve te ndryshem te gjitha llojeve, etj. Supervizion i punimeve te ndertimit ne germim dheu me punime murature e beton arme, prishje dhe punime ne toke te germuar , ndertime civile dhe ekonomike, ndertime rrugore, ndertime ura dhe vepra arti, vepra te vecanta e punime speciale, punime restaurimi, te punimeve te sinjalizimit rrugor.Keshillime per financime te ndryshme, modelim i biznesit, keshillime mbi ristrukturimin ev organizimin finanziar, studime tregu, studime plan biznesi, keshillime ne fushen e tatim taksave.Vleresime risku dhe keshillime per mitigimin e tyre.Ristrukturime te bizneseve ne veshtiresi, keshillime dhe asistence ne maredheniet me institucionet financiare, keshillime dhe bashkepunime me dhe per sektorin publik. Studime fizibiliteti.

**Neni 3**

**Kohëzgjatja e Shoqërisë**

**Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë e pakufizuar**

**Neni 4**

**Selia**

- (1) Selisa e Shoqërisë do te jetë me adresë në Rr. Andon Zako Cajupi, Nd.9, H.7 , Ap. 11, Tiranë
- (2) Adresa e faqes së internetit është ...
- (3) Adresa elektronike e shoqërisë është [lazevis@gmail.com](mailto:lazevis@gmail.com)

**Kreu II**

**Kapitali**

**Neni 5**

**Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar fillostar i shoqërisë është 100 000 (njëqind mijë) lekë, shumë e cila është depozituar në BKT me nr. Llogarie 402005723CLPRBLALLAG

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin themeltar është në përputhje me kuotat sa më poshtë:

1. Evis Laze (Ortaku i Vetëm) zotëron 100 % të kuotave, të përbëra nga 1 kuote me vlerë nominale 100.000 lekë për çdo kuotë dhe më vlerë të përgjithshme për 100 000 lekë.

**Neni 6**

**Zmadhimi dhe zvoglimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimit të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kopetente e një eksperti kontabël të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila mer vendimin në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i kapitalit prek të gjithë ortakët në të njëjtën masë të kuotave që përfaqësojnë.

**Neni 7**

**Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;



- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, përsa nuk është përcaktuar ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### Kreu III

#### Neni 8

#### Organet Vendimmarrëse dhe Drejtuese

Administrator i Shoqerise; Evis Laze , i biri i Flamurit , lindur me 22.01.1908 ne Gjirokaster, banues ne Tirane, me numer personal I90122041F

Asambleja e ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që përcakton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;



- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite.

#### **Neni 9**

#### **Mënyrat e thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme**

Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij nenit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### **Neni 10**

#### **Kuorumi**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të këtij ligji, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumin të përmendur në pikën 1 të këtij nenit, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

#### **Neni 11**

#### **Marrja e vendimeve**

Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të këtij ligji, për

ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje ë tjetra si:

- a. Përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b. Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c. Emërimin dhe shkarkimin e likujdusve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuari;
- d. Përcaktimin e shpérblimeve;
- e. Mbikqyerjen dhe përcaktimin e politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f. Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera administrative;
- g. Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Çdo ndryshim statuti duhet depozitar në QKB për tu pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

## Neni 12

### Përjashtimi nga e drejta e votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënen ose jo të përfitimeve të reja.

2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

## Neni 13

### Administrimi

#### Emërimi, shkarkimi, të drejtat dhe detyrimet

1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, i cili caktohet në statut, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Statuti mund të vendosë rregulla të posaçme për emërimin e administratorëve.

2. Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

3. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullit të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

4. Në rastet e parashikuara nga pikat 3 e 5 të nenit 82 të këtij ligji, administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblenë e përgjithshme.

5. Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë. Statuti ose rregulloret e tjera, të miratuara nga asambleja e përgjithshme, mund të parashikojnë ndryshe.

6. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontrakte me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

#### Neni 14

##### Kompetencat e administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullit të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;



dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënrat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojnë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblenë e përgjithshme, në rastet kur:

- Sipas bilancit vjetor apo te raporteve te ndërmjetme financiare, rezulton apo ekziston rreziku që aktivitet e shoqërisë nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brënda 3 muajve në vazhdim;
- Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër active, të cilat kanë një vlerë 5 % më të lartë se asetat e shoqërisë, që rezulton në pasqyrat financiare të certefikuara;
- Shoqëria, brënda dy viteve të para pas regjistrimit, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë një vlerë më të lartë se 5 % e aseteve të shoqërisë që rezulton në pasqyrat financiare të certefikuara;

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë. Statuti ose rregulloret e tjera, të miratuara nga asambleja e përgjithshme, mund të parashikojnë ndryshe.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

### **Neni 15**

#### **Përgjegjësitë e administratorëve**

#### **Emërimi, shkarkimi, të drejtat dhe detyrimet**

1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërit, i cili caktohet në statut, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Statuti mund të vendosë rregulla të posaçme për emërimin e administratorëve.

2. Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bëre në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

3. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe reportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcenojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

4. Në rastet e parashikuara nga pikat 3 e 5 të nenit 82 të këtij ligji, administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblenë e përgjithshme.

5. Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë. Statuti ose rregulloret e tjera, të miratuara nga asambleja e përgjithshme, mund të parashikojnë ndryshe.

6. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Paditë, që lidhen me shpërbimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## Neni 16

### Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia

1. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të këtij ligji, administratorët detyrohen:

a) të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mëdis;

b) të ushtrojnë kompetencat që u njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojnë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojnë dhe mënjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të garantojnë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të pikës 3 të nenit 13 të këtij ligji;

dh) të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratorët, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve

kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratorët veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standartet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratorët kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratorët janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryejnë veprimet e mëposhtme:

- a) u kthejnë ortakëve kontributet;
- b) u paguajnë ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndajnë aktivet shoqërisë;
- ç) lejojnë që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) japidin kredi.

5. Dispozitat e pikës 6 të nenit 92 të këtij ligji zbatohen edhe për paditë, që rrjedhin nga paragrafët e këtij neni. Këto padi duhet të ngrihen brenda 3 vjetëve nga kryerja e shkeljes apo nga zbulimi i saj.

#### Kreu IV

##### Viti Financiar - Ekspertët

###### Neni 17

##### Viti Financiar

Viti Financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor. Përjashtimisht viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit në QKB dhe data e mbarimit është 31 Dhjetor.

###### Neni 18

##### Ekspertët

Ekspertët kanë për detyrë të kontrollojnë të gjithë dokumentacionin kontabël tëveprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë të kontolleve periodike të ngarkuara dhe të kryera prej tij në rastet kur i është kërkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit financiar të bilancit vjetor si dhe atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë për ti shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

#### Kreu V

##### Prishja, Riorganizimi i Shoqërisë

### **Neni 19**

#### **Shkaqet e prishjes së shoqërisë**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prisht:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtarë për dy vjet dhe nuk është njofuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;
- dh) për arsyet e tjera, të parashikuara në statut.

Në këtë rast se ortakët marin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë për likujdimin e shoqërisë

### **Neni 20**

#### **Regjistrimi i Shpërbërjes**

Administratorët regjistrojnë prishjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”. Nëse prishja e shoqërisë bëhet me vendim gjykate, gjykata, në përputhje me nenin 45 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” ia njofton vendimin Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrim.

### **Neni 21**

Shoqeria hyn ne procesin e likujdimit qe ne momentin e prishjesh se saj. Per kryerjen e ketij procesi, Asamblea e Ortakeve (Ortaku i vetem) caktion nje ose disa likujdator, te cilet i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivit dhe te pasivit te shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve te likujdimit dhe mbi afatin e nevojshem te perfundimit te tyre. Ne fund te procesit te likujdimit, Asamblea e Ortakeve(Ortaku i vetem) vendos mbi bilancin perfundimtar financier dhe mbi mbylljen e procesit te likujdimit. Pas pagimit te likujdatoreve, Asamblea e Ortakeve(Ortaku i vetem) mban pjesen e mbetur te kapitalit.

### **Neni22**

#### **Baza Ligjore**

Shoqëria do të bazojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe me legjislacionin shqiptar.

Përsa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e Ligji për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, Kodi Civil si dhe çdo ligj tjeter specifik në Republikën e Shqipërisë.

### **Neni 23**

#### **ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE**

Të gjithë mosmarrëveshjet që mund të lindin për zbatimin e këtij statuti si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindi mes shoqerise dhe të tretëve, do të jetë kopetente Gjykata Shqiptare.

**ORTAKU I VETEM**

**EVIS LAZE**

